



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2022:278691

Datë: 06.03.2024

Numri i dokumentit: 05417243

**C.nr.2022:278692**

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, me gjyqtar Burhan Berisha, në çështjen juridiko - kontestimore të paditësit **A. R.** nga fsh....-komuna e Kaçankut, i identifikuar me letërnjoftim me numër personal ... të lëshuar nga MPB në Prishtinë, të cilin me autorizim e përfaqëson G. Sh., avokate nga Kaçaniku, kundër të paditurëve: **A. R. 2** me vendbanim Rr.”...” fsh....-komuna Kaçanik, **H. R.** me vendbanim Rr.”...” fsh....-komuna Kaçanik, **G. R.** me vendbanim në Rr.” ...” fsh....-Kaçanik, **Xh. R.** me vendbanim në Rr.”...” fsh....-Kaçanik, **N. R.** me vendbanim në Rr.”...” fsh....-Kaçanik, **F. R.** me vendbanim në Rr.”...” fsh....-Kaçanik, **N. R.** me vendbanim në Rr.”...” fsh....-Kaçanik, **G. R.** me vendbanim në Rr.”...” fsh....-Kaçanik dhe **Sh. D.** e vendbanim në fsh....-Ferizaj, për vërtetimin e të drejtës së pronësisë, me datë 06.03.2024, morri këtë:

**A K T G J Y K I M**

(Në bazë të pohimit)

**I.APROVOHET** kërkesëpadia e paditësit **A. R.** nga fsh. ..., Kaçanik në tërësi si e bazuar dhe **VËRTETOHET** se paditësi **A. R.** nga fsh. ..., Kaçanik, është pronar legjitim i njësive kadastrale:

**Pk.nr. ....**, në vendin e quajtur “...”, me sipërfaqe prej 170m<sup>2</sup>, **Pk.nr.....**, në vendin e quajtur “...”, me sipërfaqe prej 472m<sup>2</sup>, **Pk.nr.....**, në vendin e quajtur “...”, me sipërfaqe prej 2272m<sup>2</sup>, **Pk.nr. ....**, në vendin e quajtur “...”, me sipërfaqe prej 7258m<sup>2</sup>, **Pk.nr. ....**, në vendin e quajtur “...”, me sipërfaqe prej 6528m<sup>2</sup>, **Pk.nr. ....**, në vendin e quajtur “...-...”, me sipërfaqe prej 25594m<sup>2</sup> dhe **Pk.nr. ....**, në vendin e quajtur “...”, me sipërfaqe prej 1933m<sup>2</sup>, të cilat gjenden në Z.K....., Kaçanik, të evidentuara sipas çertifikatës pronësore me nr. 941-27825/2022 në emër të të ndjerit **H. R. .**

**II.DETYROHEN** të paditurit që paditësit të ja njohin të drejtën e pronësisë për pjesën e shënuar në pikën –I- të këtij dispozitivi dhe t'a lejojnë paditësit që të realizoj të drejtën pronësore, e tëra kjo në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

**III. DETYROHET** pala paditëse që kësaj gjykate të ia paguaj shumën prej 40€ në emër të taksës për padi.

**IV.** Ky Aktgjykim ka titull përmbartimorë dhe shërben si bazë juridike për regjistrimin paluajtshmërive në Regjistrin e të Drejtave Pronësore, ndërsa shpenzimet e procedurës i përballon secila palë.

### A r s y e t i m

Paditësi më dt.27.12.2022 në këtë Gjykatë ka ushtruar padi me të cilën ka kërkuar vërtetimin e pronësisë dhe ka theksuar se pasuria e paluajtshme evidentohet në emër të paraardhësit të të paditurve duke theksuar se paditësi me të paditurit janë në gjini gjaku dhe të gjithë së bashku janë pasardhës të të ndjerit H. M. R. (gjyshi i paditësit dhe të paditurve), i cili ka vdekur më dt. 29.06.1984 në fsh. ..., Kaçanik, në emër të cilit evidentohet pasuria kontestuese.

Paditësi është posedues faktik i paluajtshmërive kontestuese të cilat evidentohen në emër të të ndjerit H. R. dhe se të njëjtat i posedon qetë dhe pa pengesa apo pretendime nga ana e askujt përfshirë edhe të paditurit pas ndarjes me marrëveshje të paluajtshmërive ndërmjet pasardhësve të të ndjerit H. R. . Por që me insistimin e paditësit për kryerjen e procedurës së trashëgimisë dhe kalimin e pronësisë nga trashëgimlënësi në trashëgimtar të pjesës së tij të cilën e ka në posedim dhe duke konsideruar se ka të drejta reale mbi pasurinë e të ndjerit të lartëshënuar, të paditurit nuk kanë shprehur gadishmërinë për kryerjen e procedurës së trashëgimisë. Andaj duke parë mosgatishmërinë e të paditurve për t'iu përgjigjur organeve kompetente për të dhënë deklaratën e trashëgimisë, ku paditësi ka interes juridik të definimit të pasurive në fjalë detyrohet të ushtron këtë padi për vërtetimin e pronësisë pasi që konsideron se pjesa e pasurisë së lënë nga trashëgimlënësi është pronë e tij të cilën e ka në posedim dhe e shfrytëzon në mënyrë të pa penguar nga ana e të paditurve.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Të paditurit **A. R. 2** me vendbanim Rr.”...” fsh....-komuna Kaçanik, **H. R.** me vendbanim Rr.”...” fsh....-komuna Kaçanik,**G. R.** me vendbanim në Rr.” ...” fsh....-Kaçanik,**Xh. R.** me vendbanim në Rr.”...” fsh....-Kaçanik,**N. R.** me vendbanim në Rr.”...” fsh....-Kaçanik,**F. R.** me vendbanim në Rr.”...” fsh....-Kaçanik, **N. R.** me vendbanim në Rr.”...” fsh....-Kaçanik,**G. R.** me vendbanim në Rr.”...” fsh....-Kaçanik dhe **Sh. D.** me vendbanim në fsh....-Ferizaj, në përgjigje në padi të dhënë më datë: 13.12.2023 të cilën e kanë paraqitur gjykatës të nënshkruar personalisht, kanë deklaruar një zëri se nuk e kundërshtojnë kërkesëpadinë e paditësit, të njëjtën kërkesë padi e pranoj si të bazuar mbi faktet e shënuara si në padi.

Po ashtu njëzëri me anë të përgjigjes në padi deklarojnë se me përgjegjësi të plotë se janë të vetmit trashëgimtarë të rendit të parë dhe të dytë të para ardhëses H. R. dhe nuk ka trashëgimtarë të tjerë.

Shtojnë se është e vërtetë që keto parcela janë në posedim të paditësit, të njëjtën e ka në posedim paditësi që një kohë të gjatë dhe asnjëherë nuk e kemi penguar paditësin në posedimin dhe shfrytëzimin si dhe i kanë propozuar gjykatës që të marrë aktgjykim pa caktuar seancë gjyqësore dhe kanë heq dorë nga e drejta e ankesës.

Gjykata në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës siç janë: certifikata pronësore me numër: 941-27825/2022 lëshuar nga drejtoria për gjeodezi dhe kadastër K. Kaçanik, çertifikata e vdekjes me nr. Serik V..., çertifikata e vdekjes me nr.serik V..., çertifikata e vdekjes me nr.serik V..., çertifikata e vdekjes me nr.serik V., Ekstrakti i gjendjes civile me nr.serik E.nr...., Ekstrakti i gjendjes civile me nr.serik E.nr...., Ekstrakti i gjendjes civile me nr.serik E.nr...., Ekstrakti i gjendjes civile me nr.serik E.nr...., Ekstrakti i gjendjes civile me nr.serik E.nr...., Ekstrakti i gjendjes civile me nr.serik E.nr...., Ekstrakti i gjendjes civile me nr.serik E.nr...., Ekstrakti i gjendjes civile me nr.serik E.nr...., Ekstrakti i gjendjes civile me nr.serik E.nr...., Ekstrakti i gjendjes civile me nr.serik E.nr....

Gjykata nga certifikata e pronës vërtetoi se pasuria objekt i këtij kontesti evidentohet në emër të ndjerës **H. R.** dhe njëherit të paditurit janë trashëgimtarët e saj rrespektivisht djemt dhe nipat e të ndjeriës, ndërsa për arsye të panjohura nuk e kanë bërë shqyrtimin e trashëgimisë, kurse paditësi vazhdon që të ketë interes juridik për përcaktimin e statusit juridik të pasurisë së paluajtshme e që është në posedim të tij për këtë fakt nuk e kanë mohuar edhe të paditurit në bazë të përgjigjes në padi, me çka gjykata është bindur se nuk ka kontest pronësor në lidhje me këtë çështje.

Gjykata, pas pohimit të kërkesëpadisë nga ana e të paditurve me anë të përgjigjes në padi vlerësoi se pohimi i të paditurit është bërë me vullnet të lirë të pa penguar, i nënshkruar nga të paditurit, njëherit konstatoi se kërkesat janë të disponueshme për palët, prandaj, në kuptim të nenit 148, paragrafit 1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) – me të cilin përcaktohet se *“në qoftë se i padituri deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata e jep, pa shqyrtim të mëtejshëm, aktgjykimin me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesëpadinë (aktgjykimi në bazë të pohimit)”* – vendosi pa shqyrtim të mëtejshëm si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe po ashtu sipas nenit 398 par.1 të LPK-së me të cilin përcaktohet se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritator, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”* (Aktgjykim pa seancë gjyqësore). Gjykata vendosi jashtë seancës lidhur me kërkesëpadinë e paditësit.

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës vendosi si në dispozitiv të Aktgjykimit, që shpenzimet ti përballoj secila pale konform nenit 450 të LPK-së.

Nga sa u tha u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### GJYKATA THEMELORE FERIZAJ DEGA KAÇANIK

C.nr. 2022: 278692 datë: 06/03/2024.

Gjyqtari:

Burhan Berisha

---

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.

Në kuptim të nenit 181 par. 2 të LPK-së, ankesa mund të paraqitet vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore apo nga shkak se deklarata e pohimit është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit.